



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	SP-02
Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	9152-2/21
Nr. i faqeve Broj. stranica No. pages	- 07 -
Data. Datum. Date.	08 / 09 / 20 26
PRISHTINË/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	19.05.2026
REFERENC-Ë:	25/9152/793/DMM
PËR/ZA/TO:	"Met Bat" Sh.p.k. K.Gllogoc
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 25/9152/793/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për Kompaninë "Met Bat" Sh.p.k. K.Gllogoc, me nr. prot.: 25/9152/793/DMM, për Pëlqim Mjedisor për rikuperimin e materialeve të klasifikuara, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme (shtimi i kodeve të reja), P-70314067-00265-1; P-70314067-00266-1, Zona Kadastrale Sankoc, Komuna Gllogoc.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 7



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958-4/23 datë 21.04.2026), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Kompania "Met Bat" Sh.p.k. K.Glllogoc, me nr. prot.: 25/9152/793/DMM, **pajiset me Pëlqim Mjedisor** për rikuperimin e materialeve të klasifikuara, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme (shtimi i kodeve të reja), në ngastrën kadastrale nr. P-70314067-00265-1; P-70314067-00266-1, Zona Kadastrale Sankoc, Komuna Glllogoc.

Kodet e mbeturinave janë:



Kodet e Mbeturinave

07 06 01*, 07 06 03*, 07 06 04*, 07 06 07*, 07 06 08*, 07 06 09*, 07 06 10*, 07 06 11*, 07 07 01*, 07 07 03*, 07 07 04*, 07 07 07*, 07 07 08*, 07 07 09*, 07 07 10*, 07 07 11*, 18 02 02*, 18 02 05*
16 06 01*, 16 06 02*, 16 06 03*, 16 04 04, 17 04 01, 17 04 02, 17 04 05, 17 04 07, 17 04 09*02 01
04, 02 01 10, 04 01 09, 04 02 09, 04 02 10, 04 02 21, 04 02 22, 06 04 03*, 06 04 04*, 06 04 05*,
07 02 13, 12 01 15, 12 01 18*, 12 01 19*, 15 01 02, 15 01 04, 15 01 05, 15 01 06, 15 01 07, 15 01
09, 15 01 10*, 15 02 02*, 07 06 12, 07 06 99, 07 07 12, 07 07 99, 10 02 01, 10 02 02, 10 03 02, 10
03 04*, 10 03 05, 10 04 01*, 10 04 02*, 10 04 03*, 10 05 01, 10 05 08*, 10 06 01, 10 06 09*, 10 07
01, 10 07 07*, 10 08 09, 10 08 14, 10 09 03, 10 10 03, 10 11 03, 11 05 01, 12 01 01, 12 01 03, 12
01 05, 12 01 06*, 12 01 07*, 12 01 10*, 12 01 12*, 12 01 13, 12 01 14*, 15 02 03, 16 07 08*, 17 02
02, 17 02 03, 17 02 04*, 18 02 01, 18 02 03, 18 02 06, 18 02 07*, 18 02 08, 19 10 01, 19 10 02, 19
12 01, 19 12 02, 19 12 03, 19 12 04, 19 12 05, 20 01 02, 20 01 08, 20 01 10, 20 01 25, 20 01 29*,
20 01 30, 20 01 31*, 20 01 32, 20 01 33*, 20 01 34, 20 01 35*, 20 01 39, 20 01 40, 20 02 01, 20 02
03, 20 03 02

, nën kushtet si vijon:

1. Monitorimi dhe Raportimi Mjedisor

Monitorimi i Emisioneve: Të bëhet monitorimi i vazhdueshëm dhe i përhershëm i emisioneve të gazrave dhe pluhurit në ajër, si dhe i cilësisë së ujërave që shkarkohen në mjedis nga aktiviteti i impiantit.

Mirëmbajtja e Filtrave: Të bëhet monitorimi i përhershëm i sistemit dhe pajisjeve për pastrimin e gazrave. Çdo pjesë apo filtër i dëmtuar duhet të ndërrohet menjëherë për të siguruar efikasitet maksimal.

Obligimi për Raportim: Rezultatet e matjeve laboratorike duhet t'i raportohen zyrtarisht Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), në përputhje strikte me legjislacionin dhe afatet në fuqi.

2. Mbrojtja e Tokës dhe Menaxhimi i Lëndëve Djegëse



Izolimi i Rezervuarëve: Të bëhet betonimi dhe izolimi i plotë i platosë ku janë të vendosur rezervuarët për lëndë djegëse. Rezervuarët duhet të rrethohen me mur mbrojtës nga betoni (vaskë ndaluese) me kapacitet të mjaftueshëm për të parandaluar derdhjen aksidentale në tokë.

Hermetizimi i Gypave: Të bëhet mbyllja hermetike e gypave në të gjitha vendet lidhëse që shërbejnë për përcjelljen dhe transferimin e lëndës djegëse.

3. Parandalimi i Ndotjes së Ajrit dhe Pluhurit

Kapja e Gazrave dhe Pluhurit: Të bëhet mbyllja hermetike e gypave dhe kanaleve në vendet lidhëse për përcjelljen e pluhurit dhe gazrave teknologjikë. Të izolohen plotësisht të gjitha pikat gjeneruese ku mund të shfaqet pluhuri gjatë procesit.

4. Menaxhimi i Ujërave (Teknologjikë, Sanitarë dhe Atmosferikë)

Sistemi i Shkarkimit: Të vendoset dhe të funksionalizohet sistemi i plotë për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave industriale (teknologjikë), ujërave të zeza (sanitare) dhe ujërave atmosferikë nga sipërfaqet operacionale.

Trajtimi para Shkarkimit: Të gjitha këto ujëra duhet të kalojnë nëpër impiante adekuate të trajtimit (separatorin e yndyrnave/vajrave dhe gropën septike sipas standardeve) përpara se të shkarkohen apo derdhen në mjedis.

5. Menaxhimi i Mbeturinave dhe Rregullimi i Terenit

Deponimi i Sigurt: Të vendosen pajisje dhe kontejnerë të specializuar për deponimin/ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të ngurta dhe atyre të lëngëta (përfshirë kodet e reja për mbeturinat e rrezikshme dhe jo të rrezikshme).

Infrastruktura e Impiantit: Të bëhet nivelizimi, gjelbërimi dhe rregullimi i plotë i rrethojës së terrenit afër impiantit për asgjësimin e mbeturinave spitalore, medicinale dhe organike të përgjithshme.

6. Masat Emergjente dhe Trajnimi i Stafit

Plani i Rehabilitimit: Të hartohet plani i detajuar për marrjen e masave rehabilituese në rast të ndonjë incidenti, ndotjeje apo dëmtimi të mjedisit, i aplikueshëm si gjatë fazës së zbatimit (operimit) të projektit, ashtu edhe pas përfundimit të tij.



Ngritja e Kapaciteteve: Të bëhet trajnimi i obligueshëm periodik i punëtorëve në lëmin e mbrojtjes së mjedisit, menaxhimit të rreziqeve dhe manipulimit të sigurt me mbeturina të rrezikshme.

Aplikanti është i obliguar që, përpos kushteve të lartpërmendura, t'u përmbahet me përpiktëri të gjitha rekomandimeve dhe masave zbutëse të përshkruara në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM).

Nëse nuk plotësohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të anulohet (revokohet).

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumantacionin përcjellës të dorëzuar nga Kompania "Met Bat" Sh.p.k. K.Glogoc , me nr. Prot 25/9152/793/DMM, për Pëlqim Mjedisor për rikuperimin e materialeve të klasifikuara, grumbullimin , trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme (shtimi i kodeve të reja) në ngastrën kadastrale nr. P-70314067-00265-1; P-70314067-00266-1, Zona Kadastrale Sankoc, Komuna Glogoc, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nxjerrë Vendim për **lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor**.

Ky Pëlqim Mjedisor lëshohet konform nenit 29 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 të Ligjit për VNM 08/L-181.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Vërejtje: Vonesa në dhënien e përgjigjes është shkaktuar si rezultat i volumit të madh të kërkesave në procedurë dhe ndryshimit të përbërjes së Komisionit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM). Informohet se shqyrtimi i lëndës deri në fazën e mbajtjes së debatit publik është kryer nga Komisioni paraprak.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 25/9152/- ZSP/ /26 datë: 25.05.2026

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. AMMK-së
5. Kabinetit të Ministrit
6. Komunës së Drenasit
7. Divizionit për komunikim me publikun
8. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
9. Arkivit të MMPH

Bajram Kafexholli

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH



2. SHTOJÇË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithsesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

